LIGJ
Nr.9781, datë 19.7.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDACIONIT HANNS - SEIDEL TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit HANNS-SEIDEL të Republikës Federale të Gjermanisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5437, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDACIONIT HANNS-SEIDEL TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Fondacioni Hanns-Seidel, Mynih, Republika Federale e Gjermanisë, këtej e tutje referuar si Pala shqiptare dhe Fondacioni;

duke njohur rëndësinë e veprimtarisë së organizatave dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me synimin për nxitjen e kulturës dhe pjesëmarrjes demokratike dhe solidaritetit ndërkombëtar;

duke vlerësuar kontributin e Fondacionit për ndërtimin dhe zgjerimin e demokracisë, ngritjen dhe zgjerimin e një shoqërie civile funksionale dhe ngritjen dhe zgjerimin e strukturave dhe institucioneve në sektorin shtetëror, shoqëror dhe kulturor;

me qëllim sigurimin e mbështetjes ndaj Republikës së Shqipërisë në rrugën e saj drejt strukturave Euroatlantike,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë në fusha me interes të përbashkët në kuadër të kërkesave të Shtetit Shqiptar dhe të veprimtarisë së Fondacionit dhe në veçanti:

a) në sektorin "politik", Fondacioni do të kontribuojë në intensifikimin e bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, veçanërisht me Shtetin e Lirë të Bavarisë;

b) në sektorin "ekonomi", Fondacioni do të ofrojë mundësi trajnimi në fushën e menaxhimit dhe marketingut për punonjësit e ndërmarrjeve private dhe shtetërore;

c) në sektorin e "administratës publike", Fondacioni do të hartojë dhe zbatojë projekte për kualifikimin e nëpunësve të niveleve të ndryshme të Republikës së Shqipërisë në sektorët e

administratës qendrore dhe vendore.

Neni 2

Përfaqësuesit e Palëve do të zhvillojnë takime periodike për të vlerësuar gjendjen e bashkëpunimit dhe për të vendosur për planet e ardhshme dhe fusha të tjera bashkëpunimi.

Neni 3

Autoritetet kompetente shqiptare angazhohen të marrin masat e nevojshme me qëllim lehtësimin e hyrjes, daljes dhe qëndrimit të anëtarëve të Fondacionit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të përshpejtojnë dhe lehtësojnë procedurat e pajisjes me leje qëndrimi të tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Fondacioni do të jetë i përjashtuar nga detyrimet e importit dhe TVSH-së në import për realizimin e aktiviteteve të tij si: mobilje, pajisje elektronike për zyra, libra, automjete, si dhe sende personale.

Neni 5

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare që nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të zgjatet automatikisht për periudha të tjera pesëvjeçare nëse asnjë nga Palët Kontraktuese nuk jep njoftim me shkrim për përfundimin e vlefshmërisë së saj 6 muaj më përpara.

Neni 6

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e njoftimit të Palës shqiptare se të gjitha kërkesat ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

Neni 7

Marrëveshja për bashkëpunim në fushën ekonomike dhe administrative ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit HANNS-SEIDEL të Republikës Federale të Gjermanisë, nënshkruar në Tiranë më 15.11.1992, shfuqizohet.

Nënshkruar më 2.4.2007 në Tiranë në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip dhe gjermanisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Për Fondacionin HANNS-SEIDEL